



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:124771
Datë: 10.07.2023
Numri i dokumentit: 04471586

C.nr.1371/17

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Shyqri Hoxha, me bashkëpunëtorin profesional A.K. në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, Rr. "Lidhja e Pejës" Magji. Prishtinë-Fushë Kosovë p.n., të cilën me autorizim e përfaqëson G.P. i autorizuar nga kompania ".....Agency" me seli në Prishtinë, e si i autorizuar nga ana e palës paditëse, kundër të paditurit H. (S) K. nga fshati Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson av. Q.H. nga Suhareka, me objekt të kontestit padi për rimbursim të dëmit material dhe jo material, vlera e kontestit 1,155.00 (njëmijë e njëqind e pesëdhjetë e pesë) euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datën 23 qershor 2023 mori, ndërsa me datën 07 korrik 2023 hartoi, këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të **"DETYROHET** i padituri H.K. që paditëses Byrosë Kosovare të Sigurimit t'i rimbursoj shumën prej 1,155.00 euro, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 22.09.2013 në Prizren Rean dhe atë me kamatë sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim të caktuar, duke llogaritur nga dita e ngritjes së kësaj padie e deri në pagesën përfundimtare, si dhe t'i paguajë shpenzimet e procedurës të cilat do t'i caktoj kjo gjykatë, në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm" si e **pa bazuar**.

II. DETYROHET paditësja Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), që paditurit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 405.00 (katërqind e pesë) euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

1. Pretendimet e palëve

Paditësja Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson G.P. nga kompania "..... Agency" me seli në Prishtinë, e si i autorizuar nga

ana e palës paditëse, pranë kësaj gjykate me datë 26 tetor 2017, ka parashtruar padi për rimbursim të dëmit material dhe jomaterial kundër të paditurit H.K. nga fshati Komuna e Prizrenit në të cilën ka theksuar se i padituri me datën 22.09.2013 rreth orës 19:30 në Prizren Rean ka shkaktuar aksident trafiku me automjetin Suzuki Motoqikleta, me targa të regjistrimit Deri të aksidenti ka ardhur kur automjeti "A" të cilin e drejtonte H.K. i cili nga pakujdesia i shkakton dëme të dëmtuarit F.M. Më tej thekson se automjeti i cili ishte shkaktar i këtij aksidenti në momentin e shkakimit të tij ka qenë pa mbulesë siguroese, respektivisht me afat të skaduar të policës së sigurimit, si rezultat i këtij aksidenti të dëmtuarit F.M. Byroja Kosovare e Sigurimit në respektim të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia Nr.04/L-018 dhe në respektim të dispozitave të LMD-së i ka kompensuar dëmin material dhe jomaterial të pësuar si rezultat i aksidentit. Paditësja në procedurën jashtëgjyqësore i është drejtuar të paditurit por nuk kanë mundur që këtë çështje ta mbyllin, andaj kërkojnë që të aprovohet kërkesëpadija e paditëses.

I autorizuari i paditëses, nga kompania "..... Agency" me seli në Prishtinë, në seancën përgatitore edhe përgjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe shkresave të dorëzuar në gjykatë me datë 26.10.2017, se i padituri H.K. ka shkaktuar aksident trafiku, duke shkaktuar dëme materiale dhe jomateriale të dëmtuarit V.M. sipas raportit të aksidentit 2013-GR-1088, të datës 22.09.2013, në ora 19:30, ku kanë mbetur të lënduar H.K., V.M. dhe A.M. të tre kanë pësuar lëndime të lehta trupore, kanë tentuar që të arrijnë marrëveshje jashtëgjyqësore me palën e paditur, por palët nuk kanë arritur marrëveshje. Andaj gjykatës i kanë propozuar që të administrohen provat e propozuara si në padi, ashtu që pas vlerësimit të tyre të aprovoj në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e palës paditëses dhe që ta obligoj të paditurin që në emër të dëmit të shkaktuar, të paguajë paditëses shumën e dëmit material dhe jomaterial në vlerën prej 1155 euro, siç është cekur në padi dhe bashkë me të kamatën ligjore. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklarimeve nga seancat e kaluara, duke potencuar se baza e kërkesëpadisë nga ana e palës paditëse është vërtetuar nga provat e administruara, andaj nga gjykata ka kërkuar që ta aprovoj padinë dhe kërkesëpadinë si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë 30.00 euro në emër të taksës gjyqësore.

I autorizuari i të paditurit, me përgjigje në padi, në seancën përgatitore edhe përgjatë shqyrtimit kryesor ka propozuar që padinë e parashtruar ta hedhë si të parregullt apo në tërësi ta refuzojë kërkesëpadinë e paditëses, ka theksuar se padia e parashtruar është e parregullt dhe e pakuptueshme, andaj si e tillë nuk i plotëson supozimet ligjore që gjykata të procedojë sipas saj, të njëjtat duhet t'i plotësojnë të gjitha kushtet e parapara me nenin 99, 253 dhe dispozitave të tjera të LPK-së, ka theksuar se së në çfarë mënyre Byroja Sigurimeve ka vërtetuar dëmin në shumë prej 1155.00 euro, të cilën shumë paditësi kërkon nga i padituri në bazë kinse dëmit të shkaktuar, sepse nga padia e parashtruar e paditësit dhe nga provat, nuk mund ta vërtetoj atë. Kanë tentuar që të arrijnë marrëveshje

jashtëgjyqësore me palën paditëse, por palët nuk kanë arritur marrëveshje. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor pa dyshim se është vërtetuar se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe si e tillë duhet të refuzohet. Më tej ka theksuar nga provat e administruara, ujdia për kompensimin e dëmit e lidhur në mes të paditësit dhe të dëmtuarit me datë 20.01.2014 dhe nga prova e administruar transferi bankar i datës 03.02.2014, vërtetohet fakti se këtu paditësi dënim e ka paguar me datën 03.02.2014, ndërsa padia për rimbursimin e dëmit është bërë me datën 26.10.2017, andaj në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesëpadiisë pasi që duke u bazuar në nenin 357 par.1 të LMD-së, se kërkesa për shpërblimin e dëmit parashkruhen në afatin prej 3 vitesh nga momenti kur i dëmtuari ka marrë vesh për dëmin, e në rastin konkret këtu paditësja ka rënë në dijeni për dëmin me datë 24.10.2013, ndërsa urdhër transferin e ka bërë me datë 03.02.2014, ndërsa padia për rimbursimin e dëmit është bërë me 26.10.2017, pra padia është ngritur jashtë afatit ligjor për realizimin e kësaj të drejtë, përkatësisht tri vite e tetë muaj prej datës së kryerjes së urdhër transferit. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar për shkak të parashkrimit të kërkesës. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për përgjigje në padi shumën prej 104 euro, për katër seanca të mbajtura shumën prej 135 euro për secilën seancë, për një seancë të pa mbajtur shumën prej 67.5 euro, e në total 711.50 euro.

2. Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim dosjen e dëmit me numër 1993/13, të fondit të kompensimeve pranë BKS, transferin bankar të datës 03.02.2014 nga Fondi i Kompensimit, shkresën me numër 134/14 të datës 21.01.2014 nga B.L. me objekt të shkresës urdhëresë transferi, ujdi jashtëgjyqësore me numër 1993/13 të datës 20.01.2014, vendimin me numër FK-1993/13 të datës 09.12.2013, vendimin e komisionit të shkallës së parë të trajtimit të dëmeve në kuadër të departamentit të Fondit të Kompensimit pranë BKS-së, me numër 4960/13 të datës 11.12.2013, formularin për kompensimin e dëmit jo material në emër të V.M. të datës 09.12.2013, vlerësimin mjekësor në emër të V.M. e datës 22.09.2013, formularin për kompensimin e dëmit jo material në emër të A.M. të datës 09.12.2013, vlerësimin mjekësor në emër të A.M. e datës 22.09.2013, raportin e aksidentit me numër 2013-GR-1088 të datës 22.09.2013, raportet mjekësore në emër të A.M. pranë Spitalit Rajonal në Gjakovë, të datës 13.09.2013, raportet mjekësore në emër të V.M. pranë Spitalit Rajonal në Gjakovë, të datës 13.09.2013, raportin mjekësor pranë emergjencës të Spitalit Rajonal Daut Mustafa në Prizren, në emër të V.M. dhe A.M. të datës 22.09.2013, raportin e emergjencës të Spitalit Rajonal në Gjakovë, në emër të A.M. të datës 26.09.2013, konfirmimin e Policës së Sigurimeve nga BKS, e lëshuar me datë 21.01.2014, e lëshuar në emër të të siguarit A.S. procesverbalin mbi dëmtimin e automjetit me numër 1868/13, i datës 08.10.2013.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha atë së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është **e pabazuar**.

Me leximin e dosjes së dëmit me numër 1993/13 të fondit të kompensimeve pranë BKS, gjykata ka vërtetuar faktin se data e aksidentit ka qenë më 22.09.2013, kurse raportimi i rastin është bërë me datën 24.10.2013 ku të dëmtuar janë familja M. kurse shkaktar i dëmit është H.K. vlera e dëmit është vlerësuar në shumën nga 470 euro.

Me leximin e transferit bankar të datës 03.02.2014, gjykata ka vërtetuar faktin e transferimit të mjeteve nga BKS, në të autorizuarin e palës së dëmtuar B.Sh. për familjen M.

Me leximin e shkresës urdhëresë transferi nga B.L. me numër 134/14 e datës 21.01.2014, gjykata ka vërtetuar faktin se duhet të bëhet transferimi i mjeteve në shumën prej 1,155.00 euro në emër të zhdëmtimit për av. B.Sh. (për familja M).

Në bazë të ujdisë jashtëgjyqësore me numër 1993/13 të datës 20.01.2014, gjykata ka vërtetuar faktin se BKS, këtu paditësja dhe të dëmtuarit në anën tjetër familja M. me të autorizuarin av. B.Sh. nga Prishtina, kanë lidhur ujdi jashtëgjyqësore për kompensimin e dëmit material në shumë prej 1,155.00 euro, si pasojë e aksidentit të trafikut të datës 22.09.2013, në Prishtinë.

Me leximin e vendimit të paditëses me nr. FK-1993/13 të datës 09.12.2013, gjykata ka vërtetuar faktin se sipas komisionit të shkallës së parë për trajtimin e dëmeve, pas kërkesës së familja M. nga Gjakova, i është miratuar kërkesa lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 22.03.2013, në shumë prej 1,155.00 euro, të cilët kishin pësuar lëndime trupore në këtë aksident komunikacioni.

Me leximin e vendimit të komisionit të shkallës së parë për trajtimin e dëmeve në kuadër të departamentit të Fondit të Kompensimit pranë BKS-së me numër 4960/13 e datës 11.12.2013, gjykata ka vërtetuar faktin se komisioni ka vlerësuar se ka bazë juridike për kompensim si pasojë e tejkalimit të shpejtësisë, humbje e kontrollit dhe dalje në shirit të kundërt, vlera e dëmit është vlerësuar nga 470.00 euro për secilin për të dy anëtarët e familjes M.

Me leximin e formularit për kompensimin e dëmit jomaterial në emër të V.M. të datës 09.12.2013, gjykata ka vërtetuar faktin se i njëjti ka pësuar lëndim të lehtë trupor, i dëmtuari ka pësuar dhimbje me intensitet të rëndë 1 ditë, intensitet të mesëm 4 ditë, i njëjti ka përjetuar frikë me intensitet të lartë 1-2 minuta, frikë me intensitet të ulët 1 ditë, si dhe ushqimi i përforcuar ka qenë i domosdoshëm për 15 ditë.

Me leximin e vlerësimit mjekësor në emër të V.M. e datës 01.11.2013 e lëshuar nga BKS, gjykata ka vërtetuar faktin se i dëmtuari është ankuar për dhimbje në gjoks dhe qafë, ka pësuar dhimbje me intensitet të rëndë 1 ditë, intensitet të mesëm 4 ditë dhe intensitet të ulët 6 ditë, ka përjetuar frikë primare 1-2 minuta dhe frikë sekondare 1 ditë, ushqimi i përforcuar ka qenë i domosdoshëm për 15 ditë, me përfundim se dëmtimet trupore të lartcekura, bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore dhe me pa aftësi kufizuese jetësore.

Me leximin e formularit për kompensimin e dëmit jomaterial në emër të Ardiana Malazogu të datës 09.12.2013, gjykata ka vërtetuar faktin se e njëjti ka pësuar lëndim të lehtë trupor, e dëmtuara ka pësuar dhimbje me intensitet të rëndë 1 ditë, intensitet të mesëm 4 ditë, e njëjti ka përjetuar frikë me intensitet të lartë 1-2 minuta, frikë me intensitet të ulët 1 ditë, si dhe ushqimi i përforcuar ka qenë i domosdoshëm për 15 ditë.

Me leximin e vlerësimit mjekësor në emër të A.M. e datës 01.11.2013 e lëshuar nga BKS, gjykata ka vërtetuar faktin se e dëmtuara është ankuar për dhimbje të gjurit të djathtë dhe qafës, ka pësuar dhimbje me intensitet të rëndë 1 ditë, intensitet të mesëm 4 ditë dhe intensitet të ulët 6 ditë, ka përjetuar frikë primare 1-2 minuta dhe frikë sekondare 1 ditë, ushqimi i përforcuar ka qenë i domosdoshëm për 15 ditë, me përfundim se dëmtimet trupore të lartcekura, bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore dhe me pa aftësi kufizuese jetësore.

Me leximin e kërkesës të datës 24.10.2013 drejtuar B.K.S. gjykata ka vërtetuar faktin e paraqitjes së kërkesës për kompensimin e dëmit të paraqitur nga i autorizuari i palëve të dëmtuara A.M. dhe V.M.

Me leximin e raportit policor të aksidentit me nr.2013-GR-1088 të datës 22.03.2013, gjykata ka vërtetuar faktin se deri te aksidenti i trafikut ka ardhur kur vozitësi i motoçikletës si pasojë e vozitjes së pakujdesshme dhe duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes, humb kontrollin dhe kalon në shiritin e kundërt dhe direkt e godet veturën 2 që ishte në lëvizje në shiritin e vet qarkullues, ku pos dëmeve të shkaktuara në këtë aksident, lëndime trupore marrin dy persona në veturën 2 dhe vozitësi i motoçikletës.

Në bazë të leximit të raporteve mjekësore të datës 30.09.2023 pranë Spitalit Rajonal në Gjakovë, të raportit mjekësor pranë emergjencës të Spitalit Rajonal të Prizrenit "Prim.Dr.Daut Mustafa" të datës 22.09.2013, të raportit mjekësor pranë emergjencës të Spitalit Rajonal në Gjakovë të datës 26.09.2013 të lëshuar në emër të A.M. gjykata e ka provuar faktin se e dëmtuara si pasojë e aksidentit në fjalë ka pësuar lëndime dhe se e njëjta ishte trajtuar dhe mjekuar në Spitalin Rajonal në Gjakovë si dhe në Spitalin Regional të Prizrenit "Prim.Dr.Daut Mustafa".

Në bazë të leximit të raporteve mjekësore të datës 30.09.2023 pranë Spitalit Rajonal në Gjakovë, të raportit mjekësor pranë emergjencës të Spitalit Rajonal të Prizrenit "Prim.Dr.Daut Mustafa" të datës 22.09.2013, të lëshuar në emër të V.M. gjykata e ka provuar faktin se i dëmtuari si pasojë e aksidentit në fjalë ka pësuar lëndime dhe se i njëjt ishte trajtuar dhe mjekuar në Spitalin Rajonal në Gjakovë si dhe në Spitalin Regjional të Prizrenit "Prim.Dr.Daut Mustafa".

Me leximin e konfirmimit të sigurimit të datës 21.01.2014 të lëshuar në emër të të siguruarit A.S. gjykata ka vërtetuar faktin se motoçikleta Suzuki Motorfiets M2, në aksidentin e datës 22.09.2013, me rastin e shkakimit të aksidentit ka qenë pa mbulesë siguruese, respektivisht me afat të skaduar të policisë së sigurisë, pasi që validiteti ka qenë nga data 06.02.2009 e deri me datën 06.02.2010.

Me leximin e procesverbalit mbi dëmtimin e automjetit me nr.1868/13 të datës 08.10.2013, gjykata ka vërtetuar faktin e vlerësimit të dëmit të automjetit Chrysler të dëmtuarit V.M.

3. Vlerësimi përfundimtarë i gjykatës

Gjykata gjen si të bazuar pretendimin e të paditurit se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar dhe e njëjta duhet të refuzohet, sepse është përfshirë në parashkrim, andaj edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjykata vlerëson se aksidenti është shkaktuar me datën 22.09.2013 në Prizren, në bazë të dosjes së dëmit numër 1993/13 të fondit të kompensimit pranë BKS vërtetohet se me datën 24.10.2013 paditësja ka qenë në dijeni për dëmin ashtu edhe për personin i cili e ka shkaktuar dëmin, se paditësja me datën 20.01.2014 ka lidhur ujdi jashtëgjyqësore me të dëmtuarin familja M. të cilët i ka përfaqësuar me autorizim av. B.Sh. nga Prishtina dhe me datën 03.02.2014 përmes transferit bankar ka bërë kompensimin e të dëmtuarit në shumë prej 1,155.00 euro, ndërsa padia për rimbursim të dëmit material dhe jomaterial është parashtruar në gjykatë me datën 26.10.2017.

Nga shkresat e lëndës, më konkretisht nga data 26.10.2017 kur pala paditëse e ka parashtruar padinë gjykata vërtetoi faktin se e njëjta ka rënë në vonesë për të kërkuar mbrojtje gjyqësore për realizimin e kërkesës së saj, dhe atë duke u bazuar në nenin 357 par.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve (LMD), ku parashihet se "*Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin*", andaj nga të lartcekurat gjykata erdhi në përfundim se paditësja nga data 24.10.2013 kur kërkesa e saj është bërë e arritshme, më saktëisht nga momenti kur e njëjta ka ra në dijeni për dëmin e shkaktuar nga ana e palës së paditur, ka lëshuar afatin ligjor prej tre (3) vitesh për të kërkuar realizimin e të drejtës në rimbursimin e dëmit. Po ashtu edhe nëse gjykata e merr si të

mirëqenë kohën kur i dëmtuari është kompensuar nga paditësja në bazë të transferit bankar të datës 03.02.2014, përsëri kërkesa e paditëses është përfshirë në parashkrim, ngase nga koha e kompensimit e deri në momentin e parashtrimit të padisë kanë kaluar më shumë se tre (3) vite.

Mbi këtë bazë, gjykata vërtetoi faktin se kërkesa e paditëses ka arritur afatin e parashkrimit dhe rrjedhimisht detyrimi i të paditurit tanimë nuk paraqet detyrim civil i cili mund të realizohet në rrugë gjyqësore.

4. Vendimi mbi shpenzimet procedurale

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 452 par.1 të LPK-së dhe atë duke e obliguar paditësen e cila e ka humbur kontestin, që të autorizuarit të paditurit t'ia kompensoj shpenzimet procedurale dhe atë përfaqësimin në tre seanca gjyqësore shumë prej 405.00 euro (3x135.00), kurse shumë prej 67.5 euro për seancën e datës 05.04.2023 gjykata e ka refuzuar me arsyetimin se kjo seancë është shtyrë me kërkesën e të autorizuarit të palës së paditur, ndërsa shumë prej 104.00 euro për përgjigje në padi gjykata e ka refuzuar sepse i njëjti nuk ka qenë i autorizuar.

Nga të lartcekurat dhe bazuar në nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1371/17, me datë 07 korrik 2023

B.profesional
Ali Kosova

Gjyqtari
Shyqri Hoxha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtës, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.